

VENDIM
Nr. 256, datë 5.5.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 378, DATË 26.4.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘RIKUALIFIKIMI URBAN I BLLOKUT TË KUFIZUAR NGA RRUGËT ‘SULEJMAN DELVINA’, ‘MEDAR SHTYLLA’, ‘SKËNDER LUARASI’, ‘GRIGOR HEBA’ DHE ‘GJIK KUQALI’, TIRANË’”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 378, datë 26.4.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) tabelës bashkëlidhur vendimit i hiqet pasuria nr. 6/661, në emër të Bahri Osman Pinari, z.k. 8270, e llojit “truall”, me sip. 50 m², me vlerë 3 348 450 (tre milionë e treqind e dyzet e tetë mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë, me numër rendor 2;

b) në pikën 4, shifra “133 310 401 (njëqind e tridhjetë e tre milionë e treqind e dhjetë mijë e katërqind e një)” zëvendësohet me “129 961 951 (njëqind e njëzet e nëntë milionë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një)”.

2. Vlera e shpenzimeve procedurale, prej 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekësh, të përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

LISTA EMËRORE E PRONARIT, PASURIA PRONË PRIVATE E TË CILIT PREKEN NGA NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 20, DATË 15.1.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMIN NR. 378, DATË 26.4.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ‘PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘RIKUALIFIKIMI URBAN I BLLOKUT TË KUFIZUAR NGA RRUGËT: ‘SULEJMAN DELVINA’, ‘MEDAR SHTYLLA’, ‘SKËNDER LUARASI’, ‘GRIGOR HEBA’ DHE ‘GJIK KUQALI’, TIRANË’”

ISHTE										BËHET		
Nr. rendor në VKM-në nr. 20, datë 15.1.2020	Të dhënat sipas VKM-së nr. 20, datë 15.1.2020									Të dhënat e ndryshuara bazuara në konfirmimin nga ASHK-ja		
	Emri	Atësia	Mbie mri	Lloji i pasurisë	Zona kadastral e	Nr. i pasurisë	Sip. shpronësi mi m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera totale e shpronësi mit në lekë	Sip. shpronësi mi m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera totale e shpronësimit në lekë
2	Bahri	Osman	Pinari	Truall	8270	6/661	50	66,969.00	3,348,450	0	-	0